REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 14.10.2026 Prot.61 (gjashtëdhejtëenjë)

Protokoll nr. 62

I mbajtur sot më datë 14.10.2026, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3-P-V "Për detajim fonde të ardhura si kontribut financiar nga Këshilli i Qarkut Korçë";
4-P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026";

Këshilltarë të pranishëm në sallë: Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Marinathi Avrami; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Aramando Dautllari; Floreta Zaçe; Gentiana Drabo; Xhuana Hoxhallari; Ilia Xhuti; Andonaq Risto; Lulëzim Hoxhaj; Faslli Zholi; 18(tetëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Plator Çollaku; Eriseld Jonusllari Klea Baçi; Dalina Krekas; Rovena Terolli; Enida Avdolli; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Server Xhuti; 13 (trembëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu;

Ornildi Demollari:Mirë, fillojmë. Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar kryetar, të nderuar pjesëmarrës. Po fillojmë këtë mbledhje të këshillit të bashkisë, e cila është një mbledhje jashtë rradhe, e thirrur nga ekzekutivi, për dy çështje të cilat, duhet t'i kalonim përpara se të vinte mbledhja e radhës, pasi kanë kritere kohore, të themi. Së pari, bëjmë një verifikim të korumit: besoj, Gerti, janë 17 këshilltarë në sallë? 18. Korumi realizohet dhe mund të vijojmë me mbledhjen dhe me rendin e ditës, por ju jeni njohur me materialet dhe me rendin e ditës, dhe tek rendi që keni janë 4 pika. Do të desha të, me dakordësinë tuaj, të shtojmë edhe një pikë tjetër, që është një material për dy ndryshime në strukturën e bashkisë. Na i kanë sjellë pak më mbrapa, në qoftë se gjejmë mirëkuptimin tuaj, ta shtojmë edhe këtë pikë në rendin e ditës. Jemi dakord me shtesën? Kush është dakord me rendin e ditës? 18 vota pro.

Kundër ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni, të nderuar kolegë, t'ju kujtoj konfliktin e interesit. Nëse ndonjëri nga ne ka konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës, është mirë që të mos përfshihet në atë pikë, as në diskutim, as në votim. Dhe kalojmë tek pika 3 e rendit të ditës, që është projektvendim për detajim fonde të ardhura si kontribut financiar nga Këshilli i Qarkut Korçë. Do ta marrë fjalën komisioni i financës, apo t'ia japim fjalën kryetarit që të naUrdhëro, komisioni.

Petrit Kupe: Shkurtimisht, ne jemi dakord. Megjithatë, më hollësisht mund ta shpjegojë kryetari. Po dimë që për këtë projektvendim kemi marrë një vendim përpara, paraprakisht.

Ornildi Demollari:Urdhëro, zoti kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve. Shumë faleminderit që keni marrë angazhimin për të marrë pjesë edhe në këtë mbledhje jashtë rradhe. Ishin dy momente të cilat ne do t'i realizonim sa më parë, për efekt të procedurash prokurimi, edhe për t'i realizuar brenda vitit 2026. Projektvendimi i parë ka të bëjë me një ndërhyrje në rrugën e Kolanecit si fazë e dytë. Është një kontribut i këshillit të qarkut prej 10 milionë lekë. Do i shtojmë edhe rreth 5. 2 milionë lekë nga fondet e bashkisë, fonde të kursyera nga prokurimet publike të vitit 2026 për rrugët, dhe mendojmë të realizojmë rreth 700-800 metra linjarë gjatësi si fazë e dytë e kësaj rruge, për të bërë të mundur që të afrohet sa më shumë aksesi nga fshati Kolanec në drejtim të qytetit Maliq. Dua ta falënderoj edhe këshillin e qarkut për këtë suport, dhe besoj që ishte një investim i domosdoshëm. Ishte një propozim i tyre, por që u mbështet edhe nga ana jonë, ndaj edhe kjo vendimmarrje e këshillit ishte e domosdoshme. Fondi jonë është i alokuar në strukturën e rrugëve dhe s'kishte nevojë për ndryshime në buxhet, por këshilli i qarkut kërkonte edhe një vendimmarrje nga këshilli i bashkisë për efekt të realizimit të këtij projekti. Ne tashmë e kemi lidhur aktmarrëveshjen, këshilli i qarkut ka marrë vendimin dhe ne jemi gati për fillimin e procedurave. E meqë jam në këtë pikë, momenti i dytë ka të bëjë me një fond 6 milionë lekë që ne e kemi patur në buxhet për ndërtimin e për hartimin e një projekti për muzeun e Palafiteve, muzeun, por deri në këtë moment kemi patur vështirësi me institucionet qendrore për ta finalizuar. Është një projekt jo si gjithë projektet e tjera, kërkon specialistë të mirëfilltë për realizimin e saj, dhe me idenë që këtë fond të mos e digjnim, po i propozojmë këshillit të bashkisë që ky fond të kalojë për sistemim-asfaltim të rrugës së kishës në Zvirinë. Edhe ky një projekt i rëndësishëm, i kërkuar prej shumë vitesh nga komuniteti i këtij fshati. Është një kishë shumë e vjetër, e cila jo vetëm për efekt të fshatit, por edhe ka shumë vizitorë vendas dhe të huaj, si një institucion kulti shumë i hershëm dhe shumë i vizitueshëm nga të gjithë. E pamë të arsyeshme t'ju drejtohemi në lidhje me financimin edhe të këtij projekti apo të ndryshimit të fondeve, për të cilën kemi marrë ok-in edhe nga këshilli i qarkut, pasi janë fondet e këshillit të qarkut. Tashmë këshilli i qarkut në mbledhjen e djeshme ka marrë vendim për këtë transferim, kështu që vendimmarrja juaj është përfundimtare pas saj që ne të fillojmë procedurat e prokurimit. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit, zoti kryetar. Ka ndonjë pyetje për këtë? Për detajim fondi si kontribut i këshillit të qarkut? Po.

Lulëzim Hoxhaj:Përshëndetje të gjithëve. Nuk kam pyetje. Unë bie dakord për këtë transferim, por doja të thoja që në rast se ngelet kryetar ndonjë tepricë nga buxheti e këtej-andej, është mirë që të mendohet dhe këto fonde, sado që të jenë, të kalojnë në fushën e projektimit. Ka shumë rëndësi dhe ka shumë vlerë. Më mirë hedhim ca lekë për të bërë ca projekte të mira, dinjitoze, që i shërbejnë edhe perspektivës, sesa të mendojmë për gjëra kështu... kalo, bëjmë një asfalt në një vend, shtojmë një.Domethënë, mendimi im është që të... në rast se e ka, ose në rast se... ashtu me fjalë, ashtu... kjo që... ashtu me fjalë, kjo që është dakord për këtë, nuk ka problem.

Petrit Kupe: Kam dhe unë diçka.

Ornildi Demollari:Petrit, po.

Petrit Kupe: Jo në kuadrin e komisionit, por si këshilltar. Jam dakord, bile e kam biseduar paraprakisht edhe me kryetarin. Për problemin e rrugës së Kolanecit, do të sugjeroja që në fund të këtij mandati kryetari t'i japë fund rrugës së Kolanecit. Është një fshat që e kanë mbështetur vazhdimisht këshilli i bashkisë, e kanë mbështetur kryetarin. Unë e di që ka. .. është pak me koston të lartë, por duhet të... duhet në fund të fundit të kristalizohet një fshat turistik, me të vërtetë turistik, në bashkinë e Maliqit, duke qenë paraprakisht se para këtyre ngjarjeve që po ndodhin, që ndoshta deri në qershor të vitit të ardhshëm duhet të mbyllet kjo .

Ornildi Demollari:Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po. Mund të mund të sqaroj diçka? Domethënë, pavarësisht reformave, pavarësisht të gjitha ato çfarë të ndodhin, puna e bashkisë do të vazhdojë, investimet do të realizohen. Unë jam shumë dakord me atë që Luli propozon, që ne duhet të kemi projekte dinjitoze dhe të konkurrueshme në çdo fushë. Jo se ne s'kemi, por çdo ditë duhet punuar për këtë qëllim. Bile aktualisht po punojmë, kemi hedhur një detyrë projektimi për rehabilitim, zhvillim urban dhe unazën e fshatit Pojan, si një nga fshatrat më të mëdha tonat. Jemi duke hartuar një projekt të tillë me idenë që për ta financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pasi fondet janë shumë të mëdha. Aktualisht nesër kemi një lëvizje në territorin e bashkisë si ndërthurje të projekteve rajonale me drejtorin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe specialist të fondit, për të parë projekte rajonale që kanë të bëjnë, që lidhin Gramshin, Skraparin, Beratin, edhe Korçën, të themi, por veçanërisht Maliqin. Unë do jem në grupin e punës duke lëvizur në terren. Ne kemi sugjerimet tona në lidhje me ato projekte që kanë të bëjnë me lidhjen e rrugës së Korçës-Maliqit në drejtim të Beratit edhe të Skraparit, nëpërmjet linjës apo projektit që tashmë ka një projekt ide nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për ta lidhur nëpërmjet rrugës së Zerecit dhe kalimit të rrugës anës liqenit të Moglicës, i cili do ishte një zhvillim shumë i madh për të gjithë rajonin. Përveç kësaj, për të shkuar tek shqetësimi që ngriti Petriti, ne po synojmë për dy projekte të tjera, siç është Kolaneci edhe Strelca, dy fshatra që në konceptin tonë janë fshatra me bukuri të

veçanta dhe të vizitueshme, por dhe të bujtinave që kanë filluar të hapen. Kështu që në projektet e 2027-s patjetër ato do kenë përfshirjen e tyre dhe të shpresojmë që fondet nga buxheti i shtetit, pavarësisht sasisë dhe shtrirjes në kohë që do të jenë me vendimmarrjen e këtij këshilli, patjetër do të vazhdojnë edhe gjatë gjithë vitit buxhetor apo dhe në vitet e tjera. Shumë faleminderit.

Faslli Zholi:Përshëndetje të gjithëve.Desha të shtoj një diçka, duke falënderuar ekzekutivin që ka bërë përpjekjet dhe njëkohësisht edhe këshillin e qarkut që çel këtë fond për bashkinë e Maliqit. Dhe kjo është një risi e mirë. Dhe do të them që, siç u tha edhe nga kryetari, duhet të kemi kujdes, sepse edhe mandati po mbaron, e di që do të shtohen, do të bëhen. Unë kam të tjera vizione për ato punët më tej, por të paktën ne kemi rrugë edhe kemi në Novselën, për shembull, që ju e dini, është një rrugë që duhet të bëhet, edhe s'është filluar fare, është bërë vetëm brenda dhe është një rrugë shumë e këndshme edhe fshatit, se është lidhur edhe me Sovjanin, me të gjitha këto. Duhet parë edhe kjo histori. Kemi dhe rrugë të tjera për të thënë të vërtetës që është punuar, por kemi shumë gjëra për të bërë dhe kjo është mirësi që juve kërkoni dhe e morëm fondin dhe ne ndaj u mblodhëm sot që ta miratojmë këtë. Po duhet patur parasysh se ka disa rrugë që edhe ka që janë të domosdoshme. Unë përmenda atë, por edhe rrugën e Strelcës të Mesmalit, që është copë-copë. Nuk themi tash asfaltojmë, e kemi bërë me çakull, siç bëjmë edhe atë të Moglicës së lartë dhe kështu. Kështu që duke u falënderuar dhe jam dakord që ta miratojmë këtë buxhet që ka ardhur nga këshilli i qarkut. Edhe njëherë e falënderoj dhe këshillin e bashkëpunimit të qarkut me neve për këtë fond që ka dhënë. Faleminderit të gjithëve.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Kemi një gjë tjetër? E kalojmë në votim atëherë pikën 3. Kush është dakord 18 vota pro?
Kundër ka? Nuk ka abstenim. Një abstenim (Ildir Limllari) me 17 pro, një abstenim. Miratohet. Faleminderit.

Ildlir Limllari:Të bësh një rrugë është gjynah, kryetar. Ato Palafitet e Maliqit janë të vetme në Ballkan. T'i heqësh fondet për të shtuar asfalt e të lësh një muze pa bërë, prandaj jam abstenim.

Ornildi Demollari:Është tjetra kjo. Tani jemi tek ajo e Palafiteve. Jo, s'ishte. Me 17 pro, atëherë miratohet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, diçka për atë çfarë Illiri ngre me të drejtë, është e vërtetë.

Ornildi Demollari:Faktikisht edhe unë, edhe unë pajtohem me Illirin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja t'ia shpjegoj. Jo se ne do të heqim dorë nga ajo nga ai projekt. Ja ta shpjegoj, ta shpjegoj. Por momenti është që ne s'kemi pse ta djegim një fond të këtij viti buxhetor për ta realizuar dhe pastaj patjetër në fillim të vitit ne do kemi një fond prapë për këtë fond.

Ildir Limllari:Përgjegjësitë ju e keni që që ky fondi mos realizohet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo. Ne kemi kontaktuar, pasi nuk është një projekt që mund ta bëjmë ne vetë. Para dy vjetësh ja kemi dhënë këshillit të qarkut, ja kemi deleguar ne këtë fond, është edhe pjesë e fondit tonë që ja kemi dhuruar. Nuk e realizuan dot ata. Këtë vit jemi munduar me Ministrinë e Kulturës, me Drejtorinë e Përgjithshme të Monumenteve të Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, pasi është një projekt shumë specifik. Nuk mund të bëhet thjesht siç bëjmë ne projektin e një rruge, atë të një hidrovori, atë të një kanali, që futen lloj-lloj studiosh edhe mund ta bëjnë. Kurse kjo është çik shumë specifik dhe nuk po arrijmë ta realizojmë. Kjo është ai shpjegimi që po jap. Jo se do ta lëmë pa realizuar, por do një çik mend më shumë edhe një çik specializitet më të mirë, se s'duam të bëjmë diçka që të mos i rezistojë kohës.

Ornildi Demollari:Absolutisht. Pra nuk po hiqet dorë nga projekti, thjesht nuk duam të, nuk duam të digjem fondin. Mirë, kalojmë tek pika katër e rendit të ditës. Projektvendim për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2026 dhe është kjo që po diskutonim. Ka ndonjë pyetje këtu? Kryetari e ceku pak dhe shpjegoi se çfarë është. E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 18 vota por.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet me 18 vota pro. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës që është projektvendim për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq me numër dy, datë 81/2026, rishqyrtimi i vendimit të Këshillit të Bashkisë me numër 147, datë 24/12/2025, për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës dhe strukturave të tjera të varësisë i ndryshuar. Pra është ajo që thamë në fillim për disa për dy ndryshime në strukturë. Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk shtojmë punonjës, por e kemi të domosdoshme që të shtoj të bëjmë një ndryshim të të emërtesës nga shofer shërbimesh në shofer autoboti. Jemi duke blerë një botë të ujërave të zeza për, jemi duke lidhur kontratën për efekt të tërheqjes së ujërave të zeza për familjarët, për zona të ndryshme, për përmbytje kur ka raste të tilla dhe mendojmë që është një shofer në kuptimin ekstra brenda strukturave që ne kemi edhe mendojmë që ta trajtojmë si shofer të ekskavatorëve, të fadromës e të tjera. Ndaj dhe e kemi quajtur, e propozojmë këshillit edhe emërtesën dhe pagën nga 50 në 57 në 60. 000 ALL për ta parë dhe një çik më të një specialisti më të mirëfilltë të kësaj. Dhe e dyta, një mbulues çatie në USTA dhe pagën ja kemi dhënë maksimale pasi është një nga specialistët tanë më të mirë që kemi në fushën e shtrimit të pllakave e të tjera dhe duam ta trajtojmë ndryshe nga punëtorët e tjerë. Kjo është me pak fjalë. Po nuk shtohen punonjës është brenda fondit edhe brenda numrit që ju keni miratuar.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë gjë të paqartë? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 18 vota pro.Kundër ka?
Abstenim nuk ka. Miratohet me 18 vota pro. Faleminderit. Këto ishin pikat e rendit të ditës, por kemi kishte gjë kryetar?Po urdhëro. Po.

Petrit Kupe: Kryetar, kam një shqetësim nga disa familje në Drithas, rreth 70 familje të cilat kanë përfituar banesa nga viti '92-'93, por ato akoma nuk janë privatizuar. Duke qenë në detyrë për tetë vjet, kur ne jemi marrë me atë proces dhe një pjesë e tyre janë privatizuar, por rreth 17 familje të tjera, rreth 70 familje të tjera nuk i kanë privatizuar. Në fund të vitit 2014, Enti i Banesave për këto 17 familje ka nxjerrë 17 certifikata, 17 apo 13 më saktësisht nuk po e mbaj mend, ka nxjerrë certifikata pronësie në emër të komunës së Libonikut. Mbas ndryshimeve që u bënë në 2015-ën, këto janë depozituar në bashkinë e Maliqit. Këta qytetarë kanë një pjesë nga ata që janë dhe në emigracion dhe janë kthyer ose janë vazhdojnë të jenë ose janë dhe banorë këtu, kërkojnë një privatizim të tyre. Për këtë problem, për këtë problem ka ligje specifike se si kryhet procesi i privatizimit të tyre. Ka dy momente. Ose mund të jepen me qira, ose mund të mund të privatizohen. Zyra e pronave në bashkinë e Maliqit nuk e di këtë problem dhe nuk e njeh këtë problem. Unë e kam biseduar me kryetarin, prandaj dua që të vihen në lëvizje, të vihen në lëvizje dhe për arsye të privatizimit të tyre që është interesa e atyre komunitetit, por dhe për arsye financiare sepse janë të ardhura që vijnë në arkën e bashkisë. Mua më kapin ata, më kapin edhe për arsye që jam dhe këshilltar, por edhe për arsye sepse e di problemin dhe kërkoj që kryetari ta vëjë në lëvizje këtë proces ana juridike dhe e pronave që të vihet në zgjidhje. Këtë e kisha.

Ornildi Demollari:Faleminderit.

Lulëzim Hoxhaj: Ka qenë një ka qenë një bardhyl në Vreshtas në kohën e asaj dhe bëri dy fëmijë. Bëri një vajzë dhe një djalë. Shkoi në gjendjen civile në Pojanë për t'i regjistruar edhe i thotë ajo gjendja civile thotë çfarë emri do t'i vesh. Ai tha do t'ia vë tha këtij do t'ia vë Romeo tha kësaj do t'ia vë Xhuljeta. Thotë ajo jo thotë se këto nuk lejohen janë emra të huaj. Po unë unë e kam vendosur thotë t'ia vë Romeo dhe Xhuljeta. Nuk e pranoi ai. E mirë i tha ai tha po si ashtu e nxori një listë ai e pa listën ai e tha e di si është puna ta shënoj si të duash tha për mua ky është Romeo ky është Xhuljeta dhe të paregjistruar vërtetë kështu i ka dhe sot e kësaj dite.

Ornildi Demollari:Tashi ku do të dalë?

Lulëzim Hoxhaj: Ja ku dua të dalë. Tani ne me thënë të drejtën me vendimin që u mor këtu jemi të domethënë nga të nga institucion i këshillit bashkiak mbetemi të përkohshëm me fjalë dhe të ashtu. Problemi e di ku është problemi. Problemi është ky. Me thënë të drejtën, me thënë të drejtën ky vendim që u mor nga që u miratua ligji në Kuvendin e Shqipërisë ishte si të thuash ë ligji për fotografinë për fotografinë ashtu dhe u fol është folur dhe sapo e tha dhe kryetari e dëgjova dhe kryetarin pak më përpara që tha ne do mbetemi prapë tha si jo si këshill bashkiak siç jemi sot me fjalë po do të ekzistojë do do funksionojë mëvetësia themi një lloj mëvetësie pavarësie e të tjera por kjo nuk bëhet me të pritur sepse po të jetë me të pritur me të pritur ë u u pa me një fjalë se si funksionon kjo puna e të priturit. Tani cila është ideja për të thënë çik më shqip për ta thënë më përmbledhe e më të përmbledhur dhe më të se nuk duron kryetari. Tani ë është miratuar vetëm fotografia dhe mbas kësaj dëgjova një lajmet që jepen në këtë bandë domethënë po ngrihet komisioni për kompetenca. Çfarë kompetenca do të kenë ë këshillat të ardhme me çfarë kompetenca do të kenë ë për mua ka shumë rëndësi ky moment se flitet që nuk

do bashkia do të qëndrojë bashkia jo bashkia po me një emërtim tjetër ndoshta po si funksion do t'i ketë funksion po kjo për mua ë ka shumë rëndësi një përfshirje edhe ne si të zgjedhur këtu e këtej pande jo vetëm për të ruajtur një lloj ë pavarësie të ketë një pavarësi qyteti i Maliqit. Tani nga bashkia do bëhet qytet qytet ose këshilli i qytetit si mund të funksionojë si mund të jetë e këtej pande kjo ka të bëjë me kompetencat që do të delegohen por mendoj që ne duhet të përfshihemi ndoshta edhe në formë institucionale si këshill bashkiak për këtë histori që fillon fillon tani sepse kjo u mor vesh kjo kjo u mor vesh dhe ashtu iku edhe mos gënjejmë veten mos themi që tani ne ë në rast se nuk luftohet dhe nuk kërkohet domethënë nuk bëhet fjalë për bashkinë vetëm për bashkinë e e Maliqit tani po në tërësi me fjalë po gjithsesi grimca grimca bëhet e tëra edhe ne si këshill si institucion si këshill bashkiak me fjalë unë mendoj që duhet të përfshihemi duhet të mendojmë duhet të mendojmë mirë dhe duhet t'i domethënë duhet të kërkojmë ato që vërtetë vërtetë vërtetë e meriton ë kjo kjo kjo kjo bashki ky qytet ky rajon që mos mbetet pastaj një si të themi një minoritet mos mbetet kështu një aneksi i bashkisë të madhe domethënë që ë që u trajtua dhe do trajtohet nuk diskutohet kjo. Fjala është kjo me fjalë. Ne duhet të përfshihemi dhe duhet të kërkojmë që në kompetencat që do të kenë bashkitë e këtë pande të japim jo mendim thjesht mendim po edhe në formë institucionale që çfarë duhet çfarë duhet të kenë dhe si duhet të të ashtu funksionojnë këto bashkitë e mëdha dhe në tërësi tërë bashkitë në në kompetencat që duhet të kenë sepse kjo është kryesorja. Gjë tani është bërë fotografia po se u trajtua dhe në është trajtuar me fjalë dhe kam dëgjuar këtë që ë këto bashkitë që u përshkrinë edhe u kaluan në në bashkitë e tjera me fjalë ë u shkrinë e kam dëgjuar atë Maznikun kur thotë që për shembull them nuk ishin nuk ishin funksionale nuk kanë aftësi për të thithur ë jo jo nuk realizonin domethënë nuk kanë qenë nuk është po në vizionin e e tij nuk kanë qenë ë funksionale në kuptimin për të ashtu dhe nuk janë të afta me një fjalë për të për të realizuar këto. Në fakt nuk është kështu. Jo fakti fakti nuk është kështu.

Ornildi Demollari:Nuk kemi për këtë Luli.

Lulëzim Hoxhaj: Jo jo në rregull m në rregull. Po e them e di si është muhabeti. Po e them po e them po e them këtë. Ë më fal ti se ashtu puna. Po ë po e them këtë. E di pse po e them? Sepse them që nuk është vonë. Po ndoshta që tani duhet menduar meqënëse jemi këtu duhet menduar dhe duhet ashtu që në formë institucionale po them nuk them për të bërë kështu për të bërë vetëm vetëm për të folur me një fjalë për të.

Ornildi Demollari:Tani këtë duhet ta kishte thënë atë ditë që kishim e kishim në rend dite. Megjithatë ë megjithatë dakort mendimi jot.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të them ë jo Luli ka të drejtë në pikë se po flitet tani ngritja e një komisioni tjetër për kompetencat për funksionet për të tjera dhe është shumë e rëndësishme që edhe ne si institucion duke marrë në konsideratë edhe ato vërejtjet tona që kemi patur për atë çfarë ndodhi duhet të jemi të përgatitur me atë çfarë do kërkojmë. Për shembull unë me kohë kam punuar mbi atë çfarë duhet të kenë bashkitë dhe jam shumë dakort që s'ka lidhje kjo reformë s'ka lidhje që ne si bashki s'kemi qenë në lartësinë e duhur. Kjo s'ka s'ka lidhje fare.

Domethënë se performanca jonë patjetër ka qenë shumë e mirë dhe mua më vjen mirë kur marrim okejnë edhe një dritë jeshile edhe nga këshilltarë të të opozitës të cilët vlerësojnë punën që është bërë në këto vite se jo pak punë janë bërë dhe të paktën këtë e di edhe komuniteti edhe ne dhe ndaj shqetësimet janë evidente me me situatën e re që ka ardhur patjetër duhet të jemi të përgatitur për çdo gjë dhe të bëjmë propozime konkrete që çfarë duhet të kenë edhe këto qytete, kompetenca, funksione, ë përqindje të buxhetit që ato duhet të përfitojnë, vendimmarrjet, përqindja e këshilltarëve e të tjera të tjera. Shumë shumë pika ka ende që ende edhe ne nuk i dimë, por duhet të jemi të përgatitur me propozime konkrete edhe për komisionin, por dhe për strukturat e qendrës që ato të përfshihen në ndryshimet edhe të ligjit për pushtetin lokal, edhe ligjit për financat vendore e të tjera e të tjera.

Ornildi Demollari:Po patjetër.

Pranvera Begolli: Diçka kryetar, jo shkurt e kam. Banorët e një pallati që ka rënë rrufeja më takuan sot dhe më thanë çfarë është bërë për investimin e atij. Një pallat në blloku numër tre. Nuk e di.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk të kuptoj. E kemi shpjeguar shumë herë. Pallatet janë banesa kolektive të komuniteteve. Pallatet, banorët duhet të bëhen bashkë pasi nuk mund të mbulojmë ne çdo lloj shpenzimi që ka të bëjë me rehabilitimin e pallateve. Ne sa herë që kemi mundësi kemi ndërhyrë, do të vazhdojmë të ndërhyjmë e të tjera e tjera. Jemi në ato faza, kemi ndërhyrë në disa pallate, do ndërhyjmë të tjera, por kjo nuk është zgjidhja. Bile jemi jemi në atë linjë që t'ju themi banorëve që ata që janë të parët që të mund të bashkëpunojnë me këshillin e bashkisë, me bashkinë për të përfituar fonde, ne jemi të gatshëm.

Ornildi Demollari:Në rregull.Kemi gjë tjetër.Kjo ishte mbledhja për sot. Faleminderit. Ditë të mbarë në vazhdim.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.10.2026 Prot.63 (gjashtëdhejtëetre)

Protokoll nr. 63

I mbajtur sot më datë 30.10.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026"; i ndryshuar.
7.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim";
8.Informacion nga grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e ankesës së qytetarit E.Çuçllari.
9.Informacion nga ekzekutivi lidhur me kontratat e HEC-eve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë Maliq.
10.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë: Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Petrit Kupe; Idlir Limllari; Marinathi Avrami; Eriseld Jonusllari; Xhuana Hoxhallari; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Krisitna Malelli; Aramando Dautllari; Gentiana Drabo; Klea Baçi; Floreta Zaçe; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Faslli Zholi; 17(shtatëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Fevri Sherifi; Plator Çollaku;Dritan Çami; Dalina Krekas; Rovena Terolli; Enida Avdolli; Lulëzim Hoxhaj; Albina Xhejo; Ilia Xhuti; Andonaq Risto; Server Xhuti; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; 14 (katërmbëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Shërbimit Social;znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli;

Ornildi Demollari:Fillojmë? Mirëdita të gjithëve dhe një herë. Të nderuar kolegë, i nderuar kryetar i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës. Po fillojmë këtë mbledhje të radhës të këshillit të bashkisë, sikurse edhe jeni njoftuar. Nga verifikimi i kuorumit, vërejmë se kuorumi realizohet pasi janë 16 këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë me mbledhjen dhe me rendin e ditës. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por me dy shtesa me të cilat ju jeni njohur, pasi na kanë erdhur dje, dje pasdite, në mos gaboj. Kështu që miratojmë rendin e ditës me këto dy shtesa. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar: janë gjithsej 9 projektvendime, të cilat janë kthyer në vendime tashmë; 4 prej tyre kanë marrë dakordësinë e institucionit të prefekturës dhe 5 të tjera janë me karakter individual, të cilat janë kthyer në vendime edhe këto tashmë. Më lejoni, të nderuar kolegë, t'ju kujtoj konfliktin e interesit. Nëse ndonjëri nga ne ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës, është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutime, as në votim. Tani kalojmë tek pika 3 e rendit të ditës: është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar (15.09.2026, 28.09.2026) Kush është dakord me procesverbalin? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 4: projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2026. Komisioni përkatës?

Faslli Zholi: Po. Përshëndetje, kolegë këshilltarë, të nderuar kryetarë, të nderuar kryetarë këshilli, të nderuar pjesëmarrës. Ne, si komision i ndihmave ekonomike, në takimin që bëmë, duke i studiuar edhe listat, i pamë. Ju sugjerojmë që t'i kalojmë për miratim. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje për këtë? Ndonjë koment? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Ka?
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 5: projektvendim për dhënien— për dhënien e ndihmës financiare për familjet në nevojë. Komisioni?

Faslli Zholi: Po, edhe në pika 5 janë 3 familje për të cilat i keni edhe materialet përpara. Ne u konsultuam. Kush ka ndonjë sugjerim, ndonjë diçka për të na e thënë? Ne ishim dakord si komision për t'i kaluar. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje për këtë, këto familjet që përfitojnë këtë ndihmën financiare? Ka ndonjë pyetje? Ndonjë koment këtu? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet pika 5. Faleminderit. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës: projektvendim për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të bashkisë me numër 2, datë 08. 01. 2026, për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026. Komisioni i financës?

Petrit Kupe: Po, jemi dakord me këto dy ndryshime, me ndryshimin e nivelit të pagës për drejtorinë e të ardhurave në Libonik dhe në drejtorinë e shërbimeve publike. Në sektorin e mirëmbajtjes, për një punëtor mirëmbajtjeje për rishikim pamje. Ok.

Ornildi Demollari:Dakord. Faleminderit. Ka ndonjë pyetje për këtë? Ka ndonjë? E kalojmë në votim. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Ka? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet pika 6. Faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e përfituesve nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë për strehim. Komisioni ?

Ildir Limllari: Po. Është një familje rome që përfiton kredi nga programi. Jemi dakord. Ishim dakord. Miratohet.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet pika 7. Faleminderit. Tani, këtu në radhë kemi këto dy pikat për informacion. Mendoni të kalojmë? Urdhëro.

Pranvera Begolli: Në pike, meqë se jemi te pika 7 dhe te pika 8—jo, te pika 8 dhe 9, ku jepet për informacion. Aktualisht, këshilltarët nuk kanë ndonjë informacion përpara. Nuk kemi çfarë pyetje të bëjmë, kështu që mendojmë ta lëmë për një mbledhje tjetër, për informacionin që është për këta personat këtu, që ka të bëjë me këtë sqarimin, edhe interpelancat për mbledhjen tjetër.

Ornildi Demollari:Dakord jemi me këtë propozim. Po?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, kërkesa ka ardhur në datë 26. Drejtoria e shërbimit pyjor dhe drejtoria juridike kanë filluar, po i përgatit të gjithë informacionet. Po telegrafisht, unë mund t'ju shpjegoja diçka që është zbatuar udhëzimi i ministrit të mjedisit në lidhje me to. Megjithatë, që të jemi shterues për çdo gjë, do të sjellim një praktikë: të gjithë iu kemi kërkuar drejtorisë, në bazë edhe të kërkesës së bërë nga këshilltarët, që informacioni të jetë i plotë edhe të jetë shterues për çdo paqartësi që mund të kemi.

Yllson Ibrahimllari: Po, duke qenë se unë jam një nga iniciuesit e kësaj kërkese, qytetari Emanuel Çuçlari, për të mos u futur në detaje, shumë shkurtër, duke vlerësuar edhe propozimin e kryetarit dhe kryetares së komisionit, ka dërguar dhe ka shfaqur në këshillin bashkiak në datën 23 korrik. Urdhri i kryetarit është i muajit, mos gaboj, shtator; më mbrapa kanë qenë dhe periudhat e pushimeve, është e ligjshme. Dhe në procedurë, ne nuk është se kemi kërkuar domethënë, dua të sqaroj diçka me ju, kryetar, që kërkesa i ka ardhur kryesisë së këshillit në mbledhjen paraprake, si procedure.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndjesë, flas për kërkesën që ju keni bërë, për kërkesën e këtij personi. Ndoshta e kam mungesë informacioni dhe duhet—

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, s'ka gjë.Po, s'ka gjë. Duhet të jemi shumë pozitivistë në këtë punë. Edhe shterues edhe unë si juve. Goxha shterues, biles, kësaj radhe. Duke dhënë Lolën paraprakisht që të lexoj betimin e Hipokratit. Paraprakisht, kërkesa e qytetarit ka ardhur këtu dhe ndërkohë, në komunikimin tim me zëvendës-kryetarin e bashkisë, zotin Rrustemi, dhe të tjerët, për të iniciuar këtë gjë, për t'i dhënë përgjigje qytetarit, dhe në procedurën tonë, të paktën të këshilltarëve dhe në mirëkuptim të të gjitha palëve, të këshilltarëve dhe krahëve politikë këtu, për çdo kërkesë që do të vijë nga qytetarët, grupi i punës që do bëjë verifikimin në terren do të jetë mirë që këtë t'ia paraqesë këshillit. Kaq ka qenë konstatimi i parë. Sepse gjithmonë është bërë kështu, janë bërë si sulmues rekord në shënimin e golave. Shikojnë nuhatjen dhe tendencën e kryetarit të bashkisë dhe e mbajnë atë krah kur i vjen. Po përgjithësisht, jo se është faji jot, a më kupton? Ti thua që s'ke informacion dhe na i shtyn në një mbledhje tjetër. Të dyja. Qoftë grupi i punës që ka qenë në verifikimin e ankesës së zotit Emanuel Çuçlari, sepse ka një problem. Unë e kam marrë atë konstatimin e grupit të punës, siç pilotoni ju shumë mirë territorin, edhe unë për ankesat e qytetarëve të mi, sidomos kur janë nga Gora, e kam një çik informacion. Pavarësisht këshillës që më ke dhënë që nga fillimi i mandatit, që këtu asnjë gjë nuk fluturon pa lejen tuaj, unë e kam këtë kompromis, siç duket se e dinë miqësinë tuaj me mua. E di. Jo, jo, asgjë s'të shpëton. Unë jam shumë i bindur për këtë pjesë, po të mos kalojmë te kjo pjesa. Për sa i përket pjesës tjetër, që ftova dhe zonjën personalitet të mjekësisë, unë e kam të ndaluar të merrem me familjarët e mjekëve në bazë të betimit të Hipokratit. Pra, mos vijë tendenca se këtu i kërkon doktor YIlson Ibrahimlari në interpelancë. Këtu i sjell pozicioni i punës së tyre, që e kanë bërë ose s'e kanë bërë mirë, ose vijnë llafosen. I nderuar kryetar, nëse procedurën e bën Ministria e Mjedisit, regjistrin e mbajmë ne për sipërfaqet pyjore. Atëherë të vijnë të na thonë ku e kanë në regjistrin e tyre këtë parcelë dhe këto metra që kanë dhënë. Atëherë, konkretisht, siç më kupton në valë, unë po të marr vetëm një shembull, pa përmendur gjë, sepse unë kam një opinion tjetër për sa i përket investimeve në bashkinë e Maliqit dhe mundohem të tërheq njerëz që të investojnë, jo për t'i larguar. Kam një këshillë që ma ka dhënë një mik i juaj, të paktën nga arsimimi i juaj dhe i Kupes, zoti Deshamir Dhehi, dhe më ka thënë: kur takova një personalitet ministër të huaj, kur ishte zëvendës-kryeministër, më tha: "Investitorët janë si pëllumbat. Ulen një nga një, po po t'i trembish, çohen të gjithë. " Pra, unë s'kam këtë tendencë për të thënë. Secili të bëjë punën e vet. Dhe po ju them një gjë: kemi lidhur një kontratë, X po themi, e cila në drejtorinë pyjore rezulton që ne i kemi dhenë 12. 000 metra, 1. 2 hektarë, nga fondi pyjor

kullësor, kur në lejen e zhvillimit të dhënë nga ministria X ka 40. 631 metra. Unë them tani: ku i gjen metrat e tjerë ky? O ia ka marrë kryetarit të këshillit, o i ka marrë aty se s'ka pasur pronësi, o janë pronë pa frute. Unë thjesht dua ta sqaroj, se ndoshta bëjmë dhe një çik evazion fiskal, se ngrihet reizi, thotë: "I kam matur unë kur isha në kooperativë," po sot s'e ka shkopin. Mirë, faleminderit. Unë mendoj dhe kam kërkuar ligjërisht, në bazë të rregullores, qoftë grupi i punës që ka qenë në Velçan për ankesën e qytetarit, qoftë drejtoria e pyjeve dhe kullotave, të ketë këtë gjë. Dhe diçka tjetër, kryetar. Ju keni komunikuar dhe keni marrëdhënie shumë të mira me Ministrinë e Mjedisit. Ministria e Mjedisit ka thënë për korrigjimin që bën bashkarisht atje, për planin e mbarshtrimit, do të veprohet njësoj sikur të ishte plan mbarshtrimi nga e para. Të na i sjellë drejtoria pyjore, të ngremë kartonin, ta kundërshtojmë, ta korrigjojmë, të jetë i miratuar, të lutem, apo jo? Ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jam, jam shumë dakord. Grupi i punës, drejtoria e shërbimit pyjor, drejtoria juridike, të cilët ligjërisht ndjekin procedurat, mbajnë dhe përgjegjësi ligjore, të përgatisin informacionin dhe të vijnë të shpjegojnë anëtarët e këshillit për atë çfarë u thamë lart. S'kam asnjë.

Yllson Ibrahimllari: Zoti kryetar, vetëm një shtesë të vogël. Kur unë kërkoj, kur kërkoj, unë kërkoj informacion tek ju dhe tek kryetari i këshillit, më vjen përgjigjja që kjo çështje është në hetim. Kur rilidhet kontrata e re, a nuk e dimë këtë gjë, që kjo çështje është nën hetim? Prandaj të vijnë, të na i sqarojnë çfarë i takon Qezarit, jepi Qezarit Qezarit, platorin s'e kam këtu, kishës t'i japin çfarë i takon kishës. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Specifikisht nuk e sqaroj dot, por ajo çfarë ju citua, jam shumë dakord që informacioni të vijë, të shpjegohet me të gjitha modalitetet dhe të gjitha hartat. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Atëherë, të nderuar kolegë, pika 7 dhe 8 do të do të. 8 dhe 9, më falni, do të hiqen.

Yllson Ibrahimllari: Kryetar dhe diçka. Unë do sjell paraprakisht, në emër të grupit që ka hartuar kërkesën, pyetjet për të gjithë, për të dyja çështjet. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Tani kalojmë tek pikat e tjera. Janë dy pikat që shtuam së fundmi. Projektvendim për detajim fonde transferta e pakushtëzuar e trashëguar nga viti 2026. E lutem komisionin e financës.

Petrit Kupe: Për të dy pikat që shqyrtuam ne si komision, jemi dakord. Në pikën e parë bëhet fjalë për një pagesë të një projekti që financohet nga Interregu, i cili kërkon që financimi të kryhet mbasi të jenë realizuar shpenzimet. Dhe një pikë tjetër ka të bëjë me mbulimin e me përballimin e pagës në sektorin e mirëmbajtjes së rrugëve, mbasi nuk është i mjaftueshëm ai që ekziston, e sheh që nga një zë tjetër dhe e shtuan në vend tjetër. Jemi dakord.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po telegrafisht, është një fond i SASPAK-ut, fonde që jepen nga Bashkimi Europian, të cilat i janë çelur bashkisë Maliq për të mbuluar projekte që ne i përfitojmë, që jemi fitues me, por kjo ka nevojë që nga njëri projekt të kalojë në projekte të tjera. Kemi marrë ok e Ministrisë së Financave që t'i përdorim brenda grup artikujve dhe që ne t'i përdornim për projekte përsëri që janë të fituara nga Bashkimi Europian për fatura paraprake, se pastaj këto fonde kthehen përsëri. Duhesh miratimi i këshillit për të shfaqur në programin përkatës. Kurse e dyta ka të bëjë me një rishpërndarje të buxhetit. Ka një mungesë fondesh në pagat e sektorit të rrugëve. Ka një tepricë në sektorin e drejtorisë së ujitjes, i drejtorisë së kulturës. Po bëjmë një kalim që të mbulojmë pagat deri në fund të vitit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Por është brenda buxhetit të vitit 2026.

Ornildi Demollari:Ka pyetje? Atëherë, një nga një i kalojmë. Për detajimin e fondit transferta e pakushtëzuar. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër ka? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek projektvendimi tjetër për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2026. Pra, është ajo e pagave atij fondit. Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër ka? Jo.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Këto ishin pikat që kishim në rendin e ditës. Tani kemi dy dy kërkesa drejtuar këshillit. E para, janë të dyja nga njësia administrative e Moglicës dhe po ja u lexoj. Kërkesë Moglicë në 15 tetor 2026, drejtuar këshillit të bashkisë. Të nderuar këshilltarë, ne pleqësia e fshatit Moglicë, në bashkëpunim edhe me shoqatën e veteranëve të fshatit Moglicë, kërkojmë nga ana juaj të na miratoni zhvendosjen e Labipadrit të fshatit Moglicë dhe ta ndërtojmë në një vend tjetër si në shkolla nëntvjeçare ose në zyrat e njësisë administrative, pasi është vend të mirëpërshtatshëm se aty ku ndodhet tani. Kemi besim se kërkesa jonë do të merret parasysh edhe është firmosur nga një numër banorësh, rreth 20 banorë. Kjo është kërkesa e parë. Kërkesa e dytë është po nga Moglica, po në datën 15 tetor, drejtuar këshillit bashkiak Maliq për lëvizjen e Lapidarit nga vendi Kroi Buzit Bofje dhe të ndërtohet në fshatin Kodras Protopapë. Është marrë mendimi i banorëve dhe kanë dhënë mirëkuptimin duke firmosur dhe kanë firmosur edhe këtu 20 qytetarë me emrat e tyre. Këto janë dy kërkesa. Po në fakt, më falni, ekzekutiv po është përgatitur dhe projektvendimi. Më falni, më falni, duhet ta duhet ta kalojmë në votim. Urdhëro.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, unë të shpjegoj diçka. Në lidhje me Lapidarin e Protopapës, është duke qenë që ka një lapidar diku në thellësi të të maleve, të themi atje ku është zhvilluar aktiviteti i brigatës për të cilën citohet, ata kanë kërkuar që ta afrojnë brenda afër qendrave të banuara për të qenë edhe më i aksesueshëm për njerëzit dhe edhe në parim unë

mendoj që nuk është ndonjë gabim. Nuk do të thotë që lapidari që është ekzistues të prishet, po të ketë një lapidar afër qendrave të banuara, siç ata e kanë gjetur një vend mbi fshat në Kodras, ku edhe është afër njerëzve, edhe vetë është edhe i aksesueshëm nga mjetet, nga që mos ngelet në kuptimin i pavizitueshëm dhe për mua quhet normale. Është gjetur një tokë shtet nga drejtoria e e pronave, të cilat mos krijojnë probleme me pronat e banorëve të asaj zone. Nga ana tjetër, edhe lapidari i dytë, i cili është në Moglicë, është në një vend i fshehur, të themi, jo i dukshëm dhe ata si duket propozojnë një spostim dhe besoj projektvendimi që ka përgatitur drejtoria e pronave i ka marrë në konsideratë që ata të jenë më më në pah, të themi, edhe nuk besoj se mund të krijojë ndonjë problem. Besoj këshilli mund ta miratojë.

Ornildi Demollari:Po kemi një projektvendim, më falni se është gabimi im, kemi një projektvendim për të dyja pikat.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndoshta duhet të jetë dysh i shpërndarë, ndoshta ka mbetur tashmë.

Ornildi Demollari:Po, urdhëro.

Yllson Ibrahimllari: Tani unë mendoj që këto janë gjëra me sensibilitet të lartë shoqëror dhe duhet të jemi një çik të kujdesshëm. S'kam asnjë kundërshti si të doni, por do të sugjeroja që t'i merresh organizatës së veteranëve të luftës një opinion për këtë çështje. Ka qenë gaclimi i tyre. Atëherë unë flas në mungesën e dijenisë. Nëse është e tillë për pjesën tjetër të Bofjes, për pjesën tjetër të Bofjes, sepse te kjo e Moglicës kam një raport tjetër që duhet ta sqaroj dhe atë. Për sa i përket problemit të Bofjes, ajo do të ngelet aty dhe ndërkohë pjesa tjetër ndoshta me historianë, ndoshta me Akademinë e Shkencave, që në qoftë se sepse ngrihen grupe të ndryshme që ne mos i bëjmë, mos i bëjmë këto objekte sulmeve lokale, kam fjalën se vjen dikush andej matanë dhe thotë pse s'keni ngritur një përmendore për Maliq bej Dusharin, thotë edhe na këndon edhe ndonjë këngë pastaj siç i kanë ata adehet. Për sa i përket Moglicës, unë kam çik konflikt sepse kam krushqime atë zotërinë për të cilin është lapidari. Kështu që paraprakisht biem dakord vetëm mos kemi referenca sulmesh nga organizatat lokale.

Ornildi Demollari:Mund ta marrim në mund ta kalojmë në votim.

Yllson Ibrahimllari: Kjo e dyta është zhvendosje brenda një territori që është e realizueshme sepse është tek godina nga mbrapa. Hasan Hasan Moglica.

Ornildi Demollari:Selo urdhëro. Po.

Selami Muço: Po pa kaluar në vazhdim të kësaj lëvizje të lapidarëve, a i ka ardhur radha atij të fshat Maliqit të lëvizje apo jo? Se në atë gjendje para një viti e kam trajtuar këtë problem. Mbetet prapë ashtu.

Yllson Ibrahimllari: Kush është i fshat Maliqit?

Selami Muço: Lapidari që është në rrugë prej Jonus Goskovën, dy dëshmorë dhe Xhevit Goskovën dhe Jonus Selenicën.

Yllson Ibrahimllari: Tashi unë duke qenë mjeku i familjes mbretërore dikur them që atë Rizat Cerovën ta çojnë në Dolanec.

Selami Muço:Është Xhevit Goskova. Edhe është në gjendje të mjerueshme.

Yllson Ibrahimllari: Duhet riparuar. Urdhëro.

Selami Muço:O duhet riparuar o duhet zhvendosur. Mendoj që meqë jemi meqë jemi vendim meqë jemi në këtë pikë.

Yllson Ibrahimllari: Po Selua nuk na ka afruar një gjë sqarim që është më i përditshëm sesa unë. Emërtimet e çezmave të Lozhanit kush i ka bërë? Ka ndonjë vendim?

Ornildi Demollari:Ju lutem. Ju lutem. Po. Po hape mikrofonin. Hape mikrofonin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E vlerësoj shumë ndërhyrjen e Selamiut që e bën për këtë. Ne kemi ne kemi bërë disa ndërhyrje në ky lapidari që është në rrugë dhe është dëmtuar nga të themi nga pronarë që mund të kenë atë territor dhe ndoshta mund të jetë e domosdoshme një spostim i tij në drejtim të rrugës së varreve diku në kodra aty në arrat dhe në qoftë se edhe atë e bëjmë pjesë të kësaj vendimmarrje dhe ja lëmë detyrë drejtorisë së pronave që ta dokumentojë dhe mos ketë konflikt me pronat e banorëve do ishte shumë mirë.

Yllson Ibrahimllari: Do sugjeroja diçka me këtë rast. Atë lapidarin e fshatit Maliq dhe një pllakë për sabotimin do t'i sponsorizoj unë, po do t'i bësh ti me një vendim të dyja bashkarisht. Edhe atë Goskovën edhe këtu sabotimin.

Ornildi Demollari:Atëherë te projektvendimi për zhvendosjen e lapidarit në Moglicë, për ndërtimin e lapidarit në fshatin Kodras, mund të shtojmë edhe spostimin e lapidarit në fshat Maliq dhe ta kalojmë në votim.E kalojmë në votim. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër ka? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Ekzekutivi të përgatitë materialin për lapidarin e fshat Maliqit. Jo jo kemi këto tre kemi ju lutem këto tre kemi këto të treja kemi në këtë material. Faleminderit. Këto ishin pikat që kishim. Tani jemi tek diskutime të tjera. Kemi gjë?

Faslli Zholi: Zoti kryetar kemi një problem aty në lagjja e Demollarëve me puna e plehrave është një konflikt sepse qytetarët bëjnë si njëri thotë mos e lër këtu ti këtu edhe e kanë hequr koshin dhe është mbushur atje tërë plehra. Unë fola dje dhe me administratoren Rudinën dhe më tha do

vijmë ta shikojmë. I thashë hajde të shkojmë edhe kryeplaku bë vendin edhe këshillin e bashkisë sot edhe nëpërmjet jush si ekzekutiv që të shikohet vendi të caktohet një vend i përshtatshëm vend katje. Po tani dhe teket e secilit nuk mund t'i bëjmë atje dhe. Po ishte koshi e hoqën dhe kanë sjellë një katastrofë. Tashi ne duhet të ndërhyjmë të vendosim ku do të jetë koshi edhe pikë se s'do xi s'do y greku kjo nuk është mirë atje dhe është bërë keq. I marrin plehrat e i hedhin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: T'ju sqaroj ne kemi një shpërndarje të plotë për gjithë bashkinë me hartë me terra dhe në qoftë se pastaj do të bëjmë .

Faslli Zholi: Pikërisht është hequr fare dhe është bërë një katraullë aty po të vish të shikosh plus që kemi dhe atë kanalin që kemi thënë nuk e di mbeten edhe ato pulla ato janë për të riparuar

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Janë futur në procedure.

Faslli Zholi: Po presim atë që të mbyllet edhe ajo dhe vëmë edhe koshin se ata kanë konflikt atje u desh u ranë atje jo hiqe këtë hiqe këtë duhet ta zgjidhim atë punë mos jetë konflikt atje faleminderit.

Ornildi Demollari:Kemi gjë tjetër? Faleminderit ditë të mbarë.Kjo ishte mbledhja.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI